

Nr. 4746/V
Dt. 08.08.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr.525/1Prot.

Shkodër, më 4.08.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr.59, datë 27.07.2023 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES


Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet”, neni 11, pika 2, shkronja “b”, VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, Shkresës të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.4740prot., datë.2.08.2023 “Mbi materialin shoqërues të mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau-Dejës të datës 27.07.2023”, *shqyrtoi VKB Vau-Dejës nr.59, datë 27.07.2023 “Për miratimin paraprak të planit të mbarështimit të ekonomive pyjore Gomsiqe dhe Drin Gjadër –Kir, plan 10-vjeçar”*.

Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI


Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË



V E N D I M

Nr. 59 datë 27.07.2023

Për

“Miratimin e planit të mbarështimit të ekonomive pyjore Gomsiqe dhe Drin Gjadër Kirë në administrim të Bashkisë Vau Dejës”

Mbështetur Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” në zbatim të parashikimeve të ligjit nr 57/2020 datë 03.04.2020 nene 11 shkronja b “Për pyjet”, manualit të planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave janar 2019 miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nr 864 prot datë 30.01.2019 neni 2, VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” Këshilli Bashkiak Vau Dejës:

V E N D O S I :

1. **Miratimin paraprak** të planeve të **mbarështimit** të ekonomisë pyjore gomsiqe dhe drin gjader kire.
2. Afati i vlefshmerise se planeve të **mbarështimit** të ekonomisë pyjore gomsiqe dhe drin gjader kire do të jetë 10 (dhjetë) vjet .
3. Vlera e hartimit të planeve të mbarështimit të ekonomisë pyjore gomsiqe dhe drin gjader kire sipas kontrates se shërbimit me Bashkinë Vau Dejës nr 3882/12 prot me datë 30.12.2022 .
4. Efektet: Jep impaktë pozitive ne mbarështimin e fondit pyjore të ekonomive pyjore gomsiqe dhe drin gjader kire
5. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelipija



ZV/KRYETAR
Paola Pleshaj

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kunder -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 01.08 2023